REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHENDETËSISË

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Mirlinda Beqiri (Udhëheqëse e ekipit), Florë Berisha, dhe Veton Misiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia....7

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm....9

3 Rekomandimet e vitit paraprak....12

4 Qeverisja....13

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP....34

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak....36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë se Shëndetësisë për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 26-09-2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalosjet e pasurive fikse dhe stoqeve nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërën nga dy Pasqyrat Financiare ("Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme" dhe "Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale"), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. (**SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





Përgjigja e Menaxhmentit – Auditimi 2014

Menaxhmenti janë pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar që do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Ministrisë se Shëndetësisë të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehim:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të te gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të te gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e kënaqshme. Megjithëse kërkesat bazike të raportimit ishin plotësuar, konsolidimi i PVF-ve len vend për përmirësim, me fokus të veçantë tek shpalosjet në lidhje me pasuritë, stoqet, llogaritë e arkëtueshme, dhe obligimet e pa paguara. Të gjitha obligimet e tjera për raportim të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF-të ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalosjet e pasurive fikse dhe stoqeve nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërën prej dy Pasqyrave Financiare ("Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme" dhe "Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale"), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 26-09-2014, janë identifikuar rreziqe domethënëse në PVF lidhur me konsolidimin e PVF-ve, klasifikimin e shpenzimeve, dhe menaxhimin e pasurisë se organizatës. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit apo theksim të çështjes .

Rreziku i anomalive materiale në lidhje me keq klasifikimin e shpenzimeve si dhe plotësinë e pasurive ka ndodhur për shkak se menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime të kufizuara për të adresuar rreziqet e paraqitura. Mungesa e veprimit ka rezultuar në theksimin e çështjes, siç paraqitet në detaje në pjesën 2.1 më lartë.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 – Konsolidimi i Pasqyrave Vjetore Financiare

Proceset jo efektive të konsolidimit të informatave financiare brenda Ministrisë mund të rezultojnë me mos përfshirjen në PVF të vlerave materiale të pasurive dhe shpalosjeve tjera te të gjitha njësive vartëse të MSH-së.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme të Ministrisë dhe proceset tjera që lidhen me konsolidimin e PVF-ve. Ne kemi testuar zbatimin e këtyre proceseve edhe në fazën e përkohshme të auditimit dhe kemi këshilluar Ministrinë për veprimet shtesë që kërkohen për të siguruar një proces efektiv të konsolidimit për PVF-të e vitit 2014.

Çështja 2 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

Mundësia e keqklasifikimit të shpenzimeve ishte vërejtur qysh në fazën e planifikimit. Disa shpenzime për mallra dhe shërbime janë buxhetuar dhe shpenzuar nga kategoria e investimeve kapitale.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Gjatë auditimit ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për klasifikimin e shpenzimeve si dhe kemi dhënë këshilla për ti përmirësuar ato sipas nevojës. Për të përcaktuar nëse është zbatuar qasja e pritshme, ne kemi audituar disa mostra transaksionesh për të gjithë vitin financiar lidhur me kategori ekonomike specifike ku mund të ndodhin keqklasifikime të mundshme dhe kemi informuar menaxhmentin me rezultatet e punës. Kjo ka nxjerrë në pah një vlerë të keqklasifikimeve (në detaje këto janë prezantuar tek çështja 7 në ketë raport).

Rekomandimi 1 **prioritet i lartë** - Ministri duhet të sigurojë që plani buxhetor të identifikojë saktë shpenzimet sipas kategorive adekuate, në mënyrë që të ketë pasqyrim të saktë të aktiviteteve financiare të Ministrisë. Për më tepër procesi i konsolidimit duhet të përfshijë një rishikim kritik të PVF-ve nga menaxhmenti para se draft PVF të dërgohen në Thesar. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas shqyrtimit gjithëpërfshirës dhe kritik në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Raportimi financiar duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Pajtueshmërinë me SNKSP dhe kërkesat tjera të kornizës së raportimit;
- Pajtueshmërinë me kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048; dhe
- Kërkesat tjera relevante.

Në kontekst të PVF-ve, përveq pikave të shqyrtuara më lartë që lidhen me rrezikun domëthënës, ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar pjesërisht nga Menaxhmenti.

Kërkesat tjera të raportimit që nuk lidhen me PVF-të ishin adresuar në mënyrë të kënaqshme. Kjo përfshin (kërkesat buxhetore, raportet tremujore, përfshirë raportin financiar nëntëmujor, planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor për kontratat e nënshkruara, raportin vjetor të vetë-vlerësimit të organizatës, raportimin mujor për borxhet ndaj furnitorëve, etj).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Ministria kishte përgatitur një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve tona megjithatë është e nevojshme që të ndërmerren veprime shtesë për të siguruar implementimin e plotë të rekomandimeve të AP. Një rishikim periodik i këtij plani është i rëndësishëm duke marrë parasysh proceset reformuese në sektorin shëndetësor, në mënyrë që të përcaktohen përgjegjësitë për fushat e caktuara të veprimit.

Përshkrimi

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 kishte rezultuar me 23 rekomandime kryesore. MSH ka përgatitur Planin e Veprimit për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar. Plani i veprimit nuk ishte zbatuar plotësisht, prandaj disa nga rekomandimet përseriten edhe këtë vit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 3 – Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti i lartë

E gjetura Vetëm disa rekomandime nga viti i kaluar ishin implementuar, pasi që ministria nuk ka zbatuar ndonjë proces formal të zbatimit dhe implementimit të planit të përgatitur për adresimin e rekomandimeve të AP.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare kanë rezultuar në:

- Mangësi në shpalosjen e informatave në PVF;
- Mos-efikasitet në realizimin e investimeve kapitale dhe vlerë të dobët për para në praktikat e prokurimit;
- Mungesë të përmirësimeve në kontrollet që ndërlidhen me të hyrat;
- Menaxhim jo adekuat të barnave nga lista esenciale;
- Probleme ne lidhje me pagesat për kujdestaritë dhe pagesat e bordeve e komisioneve, etj.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë një rishikim të planit të veprimit për të përcaktuar qartë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, dhe stafin përgjegjës për veprimet e kërkuara. Fokusi fillestar duhet të jetë në fushat e rëndësisë më të madhe. Përveq kësaj zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në baza të rregullta, në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen barrierat që ndikojnë në mos përmirësimin e proceseve dhe aktiviteteve.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes që duhet të adresohen nga Ministria janë si në vazhdim:

- **Vetëvlerësimi** – edhe pse është zbatuar nga MSH, ka mundur të jetë më vetë-kritik gjatë vetëvlerësimit në mënyrë që kjo të shërbejë si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme;
- **Menaxhimi i rrezikut** – MSH ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave;
- **Raportimi menaxherial** – i cili duhet të formalizohet më shumë dhe të dokumentohet;
- **Sistemi i Auditimit të Brendshëm** – ku nevojitet një rindarje e burimeve dhe përgjegjësive, për t'iu përshtatur reformave të ndodhura dhe një mbështetje më efektive nga komitetet e Auditimi.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë përmirësim. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalohet që Ministria të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, menaxhimi i subvencioneve për Trajtimet Mjekësore Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore (TMJIPSH), menaxhimi i stokut farmaceutik me theks të veqantë në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik (SMSF), menaxhimi i pasurive dhe konsolidimi i PVF-ve.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Qeverisja ka të bëjë me sistemin me anë të cilit Organizatat janë menaxhuar dhe kontrolluar. Qeverisja efektive kërkon planifikim të fortë, monitorim dhe aranzhime raportuese të cilat qartë adresojnë rreziqet operacionale dhe strategjike me të cilat përballen Organizatat.

Vitit 2014 ka sjellur zhvillime të vazhdueshme në sektorin e shëndetësisë me ndikim në MSH dhe menaxhimin e përgjithshëm në këtë sektor. Janë formuar struktura të reja menaxhuese si Agjencia për Financimin e Shëndetësisë (AFSH) që do të pasohet me krijimin e Fondit të sigurimeve shëndetësore dhe është krijuar Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHKSUK) i cili merr nën menaxhim të gjitha Spitalet e Përgjithshme dhe QKUK-në. Derisa AFSH do të merret me negocimin dhe kontraktimin e shërbimeve esenciale shëndetësore si dhe barnave dhe materialit shpenzues nga lista esenciale. SHKSUK-ja do të menaxhojë me të gjitha Spitalet e Përgjithshme dhe me të gjitha klinikat e QKUK-së. Tranzicioni/ndryshimi është në zhvillim dhe kjo merr kohë. Krijimi i mekanizmave menaxhues dhe të kontrollit, si dhe të kuptuarit e e përgjegjësivë të reja janë sfiduese. Janë adresuar standarde të reja të raportimit dhe struktura të mbikqyrjes, mirëpo ato duhet të zbatohen në praktikë.

Aktivitetet e sektorit shëndetësor gjatë vitit 2014 janë të pasqyruara në PVF e MSH-së dhe ne i kemi vënë theks të veqantë procesit të konsolidimit të informacioneve i cili nuk ishte në nivelin e pritur.

Çështja 3 – Mangësi në procesin e raportimit dhe konsolidimit të PVF-ve – Prioriteti i lartë

E gjetura Raportimi mujor në Ministri nuk ishte i dokumetuar dhe formalizuar sa duhet. Në procesin e konsolidimit të pasqyrave nuk janë marrë për bazë një numër i raporteve financiare të Institucioneve vartëse për shkak të gabimeve të paraqitura në to. Përveq kësaj një pjesë e informatave të shpalosura në PVF, si informatat në lidhje me pasuritë përfshirë stokun farmaceutik, borxhet dhe të arkëtueshmet nuk ishin të sakta.

Rreziku Kërkesat aktuale të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët e reduktojnë efektivitetin e menaxhimit brenda Ministrisë. Kjo zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave financiare. Po ashtu, mund të dërgoj deri tek gabimet në PVF.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë monitorim të afërt të implementimit të strukturave të reja shëndetësore duke siguruar që linjat e raportimit dhe llogaridhënies janë dizajnuar dhe implementuar si duhet. Dobësitë aktuale duhet të zvoglohen/zbuten nga një sistem i fortë dhe transparent, me ndarje të duhur të detyrave, të kuptuar plotësisht nga menaxheret në të gjitha nivelet.

4.2 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MSH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	**114,708,481**	**120,537,254**	**111,409,971**	**99,521,409**	**87,305,055**
Granti i Qeverisë -Buxheti	110,758,382	116,210,234	106,656,902	95,373,804	82,714,488
Të hyrat vetanake[2]	3,950,099	4,327,020	3,949,999	3,685,983	4,562,681
Donacionet e jashtme	0	1,322,484	426,149	461,621	27,886

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 5,828,773€.

Gjatë vitit 2014 MSH kishte përdorur 92% të buxhetit total, pak më mirë krahasuar me vitin paraprak (91%). Kjo përqindje është ndikuar nga realizimi i ulët i buxhetit të investimeve kapitale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**114,707,481**	**120,537,254**	**111,409,971**	**99,521,409**	**87,305,055**
Pagat dhe Mëditjet	45,033,968	52,972,895	52,854,734	44,408,183	42,527,654
Mallrat dhe Shërbimet	42,463,572	38,817,679	36,324,871	38,332,671	29,167,678
Shërbimet komunale	4,506,216	3,871,169	3,739,731	3,388,643	3,871,062
Subvencionet dhe Transferet	4,703,725	9,881,142	9,683,042	4,763,603	2,841,184
Investimet Kapitale	18,000,000	14,994,369	8,807,593	8,628,309	2,654,553

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave
[2] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga ishte rezultat i vendimit të qeverisë për rritje të pagave e zbatuar nga prilli 2014;
- Zvogëlimi i buxhetit për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale, ishte bërë me vendim të qeverisë me qëllim të kursimit. Me gjithë zvoglimin e buxhetit te këto kategori Ministria në fund kishte mjete të pashpenzuara prej 2,624,246€, njëkohësisht kishte edhe obligime të papaguara mbi 3,000,000€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur në bazë të vendimit të qeverisë për krijimin e fondit të veqantë për financimin e trajtimit të fëmijëve të sëmurë me leukemi; dhe
- Buxheti për investime kapitale megjithëse ishte zvogëluar për rreth 17% në krahasim me buxhetin fillestar, në fund ka arritur të realizohet vetëm 59% e buxhetit final.

Tabela 3. Të hyrat vetjake – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	3,950,099	4,327,020	5,213,948	4,215,387	3,925,512

Të hyrat vetjake të ministrisë gjatë 2014 ishin 5,213,948€. Ato janë shfrytëzuar kryesisht për Paga dhe Mëditje. Totali i të hyrave të inkasuara reflekton një rritje prej rreth 24% krahasuar me vitin paraprak. Mbledhja e te hyrave mbetet sfidë për këtë organizatë.

Rekomandimi

Çështja 4 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

E gjetura Nënshpenzimi i buxhetit për investime kapitale ka ndikuar në përqindjen totale të realizimit të buxhetit. Poashtu një pjesë e buxhetit të mallrave dhe shërbimeve nuk ishte shpenzuar, njëkohësisht Ministria në fund të vitit kishte vlera të konsiderueshme të obligimeve të papaguara.

Rreziku Planifikimi jo i duhur dhe realizimi i ulët i buxhetit rezulton në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të sigurojë informata cilësore nga strukturat themelore të sistemit shëndetësor si bazë për monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore. Duhet të identifikohen dhe adresohen barrierat për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, ose nuk janë më të vlefshme, kjo duhet adresohet në rishikim buxhetor të mes vitit dhe të reflektohet pozitën e buxhetit final.

4.3 Të hyrat

Përshkrimi

Të hyrat gjatë vitit 2014 ishin 5,213,948€. Kjo paraqet rritje për rreth 24%, krahasuar me vitin paraprak. Këto të hyra përbëhen nga: participimet e pacientëve, të hyrat nga licencat për produkte medicionale dhe licenca të tjera, çertifikatat mjekësore etj.

MSH dhe institucionet vartëse kanë kryer barazime të rregullta në lidhje me të hyrat e mbledhura me nivelin tretësorë dhe dytësor, mirëpo nga testimet e kontrolleve dhe testimet substanciale ne kemi konstatuar se kontrollet aktuale nuk janë të mjaftueshme dhe si të tilla kërkojnë përforcim të mëtejmë.

Rekomandimi

Çështja 5 - Mangësitë ne regjistrimin e të hyrave – Prioritet i lartë

E gjetura

Regjistrimi i të dhënave për të hyrat e inkasuara nga participimet bëhet në mënyrë manuale. Kjo për shkak se MSH dhe institucionet shëndetësore nuk posedojnë ndonjë softuer për menaxhimin e tyre. Të dhënat manuale ekzistuese menaxhohen në mënyrë të dobët.

Në AKPPM nuk janë mbajtur regjistra të brendshëm në lidhje me të hyrat e mbledhura, derisa për qëllime të raportimin janë shfrytëzuar të dhënat në SIMFK.

Rreziku

Sistemet ekzistuese manuale për informacionet mbi të hyrat mund të jenë subjekt i gabimeve apo manipulimeve. Pasaktësia e evidencave për të hyrat krijon vështirësi në menaxhimin e tyre dhe rrit rrezikun e marrjes se vendimeve në bazë të informatave të pamjaftueshme.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të sigurojë se janë shqyrtuar të gjitha mundësitë teknike dhe profesionale që në kuadër të SISH-it të funksionalizohet moduli i të hyrave. Veç kësaj kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të zbatojë mekanizma të kontrollit që mundësojnë koordinimin e informatave në mes të departamenteve që krijojnë të hyra dhe departamentit të financave për të pasur informata të sakta në lidhje me të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Shpenzimet totale te realizuara përmes procesit te prokurimit arrijnë vlerën 42,093,482€. Janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Pagesat për furnizim me barna nga lista esenciale është trajtuar si pjesë e veçantë pasi përbejnë përqindjen me të lartë të këtij popullacioni me rreth 57% (shih nënkapitullin 4.5.2).

Rekomandimet

Çështja 6 Dobësi në proceset e prokurim – Prioriteti i mesëm

E gjetura

Në kontratën Furnizim me pajisje të IT, për një nga artikujt (llaptopet) me çmim 1,021€, sasia ishte përcaktuar vetëm një njësi, derisa për modele tjera (PC) më çmim më të lirë (574€) sasia e paraparë ishte 10 njësi. MSH ishte furnizuar me 10 llaptop me çmimin 1,021€, derisa nuk është furnizuar fare me PC që kishte çmim më të ulët.

Blerje jo në përputhje me kontratën - Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka shfrytëzuar kontratën e lidhur nga SHSKUK për furnizim me shtretër për pacient për disa reparte. Ne gjetëm se për repartin e emergjencës ishin furnizuar me gjashtë shtretër të cilët nuk posedonin specifikat e dy llojeve të kontraktuara ndërsa ishin faturuar me çmimin e produktit me të shtrenjtë po ne atë kontratë.

Ministria ka blerë 3 telefona mobil, ndërsa as në kontratë e as në raportin e pranimit të mallit nuk ka informata mbi llojin e telefonave të blerë.

Rreziku

Menaxhimi i dobët i kontratave shkakton dëmtim të buxhetit dhe vënë në pikëpyetje vlerën e arritur për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi 6

Ministri duhet të sigurojë që drejtori i prokurimit kryen një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit. Përveq kësaj, duhet të zhvillohen procese dhe kontrolle më të mira për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar. Njëjtë duhet të veprojë edhe drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, në lidhje me çështjet e identifikuara në institucionet që janë nën menaxhimin e tij.

Çështja 7 – Keqklasifikim i shpenzimeve të bëra përmes prokurimit – Prioritet i mesëm

E gjetura

Në shumë raste pagesat janë regjistruar në kodet joadekuate. Për shembull: Pagesa për bashkëfinancimin e objektit të QKMF-së në Skenderaj prej 1,100,000€ ishte regjistruar në SIMFK si objekt banimi e jo si objekt shëndetësor.

Klasifikimin e Gabuar shpenzimeve ka përcjellë prokurimin e furnizimeve të ndryshme[3] në Administratën Qendrore, IKSHP, QKUK dhe në Spitalet e Përgjithshme në Prizren[4] dhe Pejë[5]. Të gjitha këto janë blerë nga Investimet Kapitale ndërsa është dashur të blihen nga mallrat dhe shërbimet. Totali i këtyre pagesave arrin vlerën 289,486€. Duhet të ceket se në këto raste mjetet kanë qenë të buxhetuara në kategori jo adekuate të shpenzimeve.

Rreziku

Keqklasifikimet e shpenzimeve shkaktojnë pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve dhe ndikojnë në cilësinë e informatave në PVF, duke mbivlerësuar shpenzimet kapitale dhe nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të sigurojë që kjo problematike të përcillet duke filluar nga procesi i buxhetimit në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen në kategoritë adekuate për të ofruar një pamje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.

[3] Blerja e pajisjeve të IT-Ilir Kosova 35,508€ dhe Printec 48,187€, mobilje dhe inventar medicional 23,702€, material medicional dhe mobilje për emergjence 13,244€ dhe inventar medicional dhe administrativ 9,742€;
[4] Ne SP Prizren, katër pagesa te bëra nga Investimet Kapitale, i takonin Mallrave dhe Shërbimeve, vlera totale e tyre ishte 41,662 euro;
[5] Ne SP Peje ishin 6 pagesa vlera totale e te cilave arrinte vlerën 117,441 euro.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Në këtë kategori të shpenzimeve hyjnë shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, drekat zyrtare, komunalitë etj.

Rekomandimi

Çështja 8 - Pagesa e shërbimeve nga buxheti i shpenzimeve komunale - Prioriteti i mesëm

E gjetura	Në AKPPM pagesat për shërbime të veçanta me vlerë të përbashkët prej 13,397€, janë paguar nga buxheti i planifikuar për shpenzime komunale (kodi 13260).
Rreziku	Pagesa e shërbimeve nga buxheti i shpenzimeve komunale shkakton pasqyrim joreal të shpenzimeve në pasqyrat financiare duke mbivlerësuar njërën, dhe duke nënvlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve. Kjo është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme, dhe shpije në keqkuptim të pozitës financiare të institucionit.
Rekomandimi 8	Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të sigurojë që të gjitha pagesat dhe shpenzimet të realizohen në përputhje me planifikimet paraprake, dhe të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagesat e pagave dhe mëditjeve bëhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar. Megjithatë ekzistojnë një serë kontrollesh që zbatohen nga MSH-ja si autorizimi i listës së pagave, verifikimi i ndryshimeve të mundshme, rishikimi i buxhetit për këtë kategori, autorizimi i shtesave dhe kujdestarive etj. Buxheti i planifikuar për paga dhe mëditje ishte 45,513,848€.

Ne kemi testuar procedurat e kompensimit të punonjësve, rregullsinë e kontratave dhe pagesat e kujdestarive për stafin shëndetësor.

Rekomandimet

Çështja 9 – Rritja e paqartë e vlerës së kujdestarive – Prioritet i lartë

E gjetura Ministria kishte rritur vlerën e kujdestarive të mjekëve në QKUK pa asnjë bazë ligjore dhe pa aprovimin e Ministrisë së Financave. Kjo rritje ishte aplikuar për muajin Maj dhe Qershor. Pasi nuk kishte ndonjë vendim të nënshkruar apo të mbështetur ligjërisht, këto pagesa nuk kanë vazhduar më tej. Për këta dy muaj pagesat e tilla arrijnë vlerën rreth 182.862€.

Rreziku Rritja e vlerës se kujdestarive nuk ishte e paraparë në buxhetin e vitit 2014, dhe nuk kishte ndonjë bazë ligjore. Si e tillë kjo rritje ka shkaktuar dëmtim të buxhetit të MSH-së.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë që drejtori i përgjithshëm i SHKSUK-së të analizojnë çështjen e identifikuar nga ky auditim, të përcaktojë shkaktarët e ndodhjes si dhe masat e nevojshme në mënyrë që të shmangen pagesat e paarsyeshme dhe të cilat janë në kundërshtim me ligjet aplikueshme. Përveq kësaj mjetet e paguara tepër duhet të kthehen në buxhetin e Ministrisë.

Çështja 10 Kalkulimi i kujdestarive – Prioritet i mesëm

E gjetura Kontrata Kolektive Sektoriale (KKS) është dokument unik i cili shpjegon mënyrën e përllogaritjes së kompensimit për kujdestaritë. Mirëpo ne kemi gjetur se në asnjë nga institucionet shëndetësore nuk është përdorur bazë e njëjtë për llogaritjen e kujdestarive.

Shembull SP Prizren aplikon çmimore të ndryshme nga KKS. Në 16 nga 21 mostrat e testuara kishte gabime financiare të cilat kanë rezultuar me mbipagesë prej 400€ vetëm në një muaj.

Poashtu hasëm në raste kur angazhimet në kujdestari tejkalonin orët optimale që mund të realizohen brenda muajit (bazuar në ligjin e punës).

Në disa klinika, drejtori i klinikës e cakton dhe aprovon kujdestarinë vetvetes.

Në SP Pejë në hasem në raste kur doktorët që mbanin kujdestari në të njëjtën kohë paguheshin edhe për gadishmëri si dhe disa prej tyre deri në muajin maj 2014 përfitonin 10% të pagës bazë në emër të punës në komisionin për aprovim të pushimeve mjekësore për stafin shëndetësor, punë kjo që bëhej brenda orarit të rregullt të punës.

Rreziku Efekti financiar i mospërputhjeve të evidentuara nuk është edhe aq i madh, mirëpo fakti i ekzistimit të dallimeve në pagesat e kujdestarive është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë që Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së të aplikojë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive, në mënyrë që të sigurohet se raportet mujore që procedohen për pagesë janë të bazuara në ditarët e kujdestarive. Çdo pagesë e cila nuk është në harmoni me ligjin e punës dhe KKS duhet të anulohet.

Çështja 11 Mbajtja e pozitave kyçe me ushtrues detyre dhe si punë sekondare - Prioritet i lartë

E gjetura Shtatë pozita kyçe në menaxhmentin e MSH-së përfshirë edhe udhëheqësen e barnatores në QKUK janë të plotësuara me ushtrues detyre, me një kohëzgjatje me shumë se tre muaj, dy prej të cilëve ushtrojnë këtë detyrë që nga shtatori i vitit 2013.

Pozitat menaxheriale vazhdojnë të mbahen si punë sekondare në IKSHPdhe QKSUK. Zyrtarët në fjalë kanë kontratë të rregullt pune dhe përfitojnë pagë primare edhe nga një organizatë tjetër buxhetore.

Rreziku Ushtrimi i detyrës në periudhë më të gjatë se tre muaj, është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe mund të rezultojë me përfomancë të ulët operacionale. Pozitat menaxheriale me pagë sekondare (20 orë në javë) poashtu shkaktojnë rezultate jo të mira në punë pasi për udhëheqjen e pozitave drejtuese kërkohet angazhim i plotë kohor.

Rekomandimi 11 Ministri, drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së dhe drejtori i IKSHP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe në me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.

Çështja 12 - Angazhimi me kontrata mbi vepër për pozitat e rregullta të punës– Prioriteti i lartë

E gjetura Në AKPPM, për 13 pozita të rregullta ishin angazhuar punonjës me kontrata mbi shërbimet e veqanta. Kohëzgjatja e angazhimit të gjashtë prej tyre ishte më e gjatë se sa parashihet me legjislacionin në fuqi. Në lidhje me këtë theksojmë faktin se organogrami aktual i AKPPM-së është i vjetruar dhe nuk korespondon me nevojat aktuale të institucionit, ngase shumë pozita të nevojshme nuk janë të parapara në organogram.

Në QKUK në katër raste ishin angazhuar infermiere me kontrata mbi shërbimet e veqanta. Ngjashëm ka ndodhur edhe në SP në Pejë ku këto pozita në kohën e pushimeve vjetore zëvendësoheshin për një kohë të caktuar duke angazhuar individ me kontratë mbi vepër.

Rreziku Angazhimi i punonjësve me kontrata mbi shërbimet e veqanta, minimizon konkurencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara. Derisa tejkalimi i kohëzgjatjes së këtyre kontratave më shumë se 6 muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të sigurojë aprovimin e organogramit të ri konform nevojave aktuale. Për plotësimin e pozitave të rregullta të punës të zhvillohen procedura të rregullta të rekrutimit. Edhe zëvëndësuesit në QKUK dhe në Spitalet e Përgjithshme duhet të rekrutohen në bazë të konkursit të rregullt konform parimeve të Ligjeve të aplikueshme.

Çështja 13 – Mbipagesa për personin e pezulluar nga puna- Prioritet i mesëm

E gjetura Bazuar në ligjet në fuqi në rast të suspendimit të përkohshëm të punësuarit i takon pagesa prej 50% e pagës bazë. Suspendimi mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj, pastaj punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë Kontratën e Punës. Ish kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së ishte suspenduar nga puna në shtator 2013. Këtij zyrtari për nëntë muaj i janë paguar më shumë se 50% e pagës dhe vlera totale e pagesave të tepërta gjatë 2014 ishte 2,839€.

Komisioni Disiplinor i AKPPM në fund të prillit 2014 ka marrur vendim që për inspektorin e IFPPM të shqiptohet masa disiplinore "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi për 1 vit". Ishte bërë kërkesë në M.SH për tranferimin e tij në një pozitë me gradë të njëjtë mirëpo transferimi i tij nuk ka ndodhur. Zyrtari në fjalë vazhdon të paguhet edhe pse nuk vijon punën. Totali i pagesave që nga vendimi për transferim arrin vlerën 5,009€.

Rreziku Mbipagesat për punëtorët e pezulluar nga puna dhe pagesat e punëtorëve përkundër mos vijimit në punë krijojnë shpenzime të paarsyeshme dhe e ngarkojnë pa nevojë buxhetin e institucionit.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë që Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së ti adresojë këto çështje, dhe të shqyrtohen mundësitë ekziztuese ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të paguara tepër.

Çështja – 14 Pagesa e bordeve dhe komisioneve – Prioritet i mesëm

E gjetura

Gjatë vitit Ministria kishte paguar për borde dhe komisione të ndryshme vlerën prej 371,188€. Zyrtarë të caktuar vazhdojnë të jenë anëtarë në shumë komisione. Dokumentimi i takimeve dhe punës së tyre len vend për përmirësim.

Edhe në AKPPM funksionojnë dy borde të formuara në bazë të U.A 13/2013 dhe 14/2013, dhe disa komisione që shqyrtojnë qështje të ndryshme si përshtatjen e kushteve teknike për licencimin e qarkulluesve me shumicë dhe pakicë etj. Gjatë vitit 2014, sipas llogaritjeve tona janë shpenzuar rreth 90,000€. Shumica e anëtarëve te komisiove janë punëtorë te AKPPM-së.

Pagesat për këto borde dhe komisione megjithëse janë të themeluara më vendime të Qeverisë, janë në kundërshtim me nenin 80 të LMFPP-së.

Rreziku

Këto pagesa janë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret ne fuqi pasi zyrtarët të cilët marrin pjesë në komisione, borde ose ndonjë organ apo autoritet tjetër publik, nuk kanë të drejtë të pranojnë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim.

Rekomandimi 14

Ministri duhet të iniciojë zhvillimin e një politike të re duke specifikuar në mënyrë të qartë parimet udhëzuese për anëtarët në bordet dhe komisionet në sektorin e shëndetësisë, bazuar në parimet e përgjithshme në lidhje me këko aranzhime. Të konsiderohet mundësia e përcaktimit të numrit të takimeve të bordeve dhe komisioneve si dhe çështjeve që do të shqyrtohen brenda takimit.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Gjatë vitit 2014 për subvencione ishin shpenzuar 9,683,041.61€, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve përdoren për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe trajtimin e fëmijëve të sëmurë me leukemi).

Rekomandimet

Çështja 15 - Mangësi në menaxhimin e Subvencioneve – Prioritet i lartë

E gjetura Nga testimet tona kemi vërejtur se menaxhimi i subvencioneve vazhdon të ketë dobësi. Disa nga dobësitë e vërejtura janë:

- Ministria vazhdon të bëj pagesat për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore duke u bazuar në pro faturat që i sjellin pacientët në kohën e aplikimit. Mirëpo pas trajtimit pacientët nuk i kanë sjellë dëshmitë për marrjen e shërbimeve dhe faturat përkatëse për ti arsyetuar shpenzimet.
- Në një rast pacienti ishte subvencionuar mbi bazën e raportit të komisionit konziliar të nënshkruar vetëm nga një mjek. UA i aplikueshëm kërkon që ky raport të nënshkruhet nga tre mjek, në këtë rast në emër të tyre ishte nënshkruar personi i njëjtë.
- Sipas UA në fuqi Bordi Ekzekutiv i TMJIPSH aprovon/refuzon propozimin e Komisionit për Vlerësim Mjekësor për trajtim të pacientit, dhe rekomandon institucionin dhe shumën e mjeteve për trajtim. Nga mostrat e testuara ne nuk kemi hasur në asnjë rast kur bordi ka rekomanduar ndonjë vend për trajtim.
- Në një rast bordi kishte aprovuar vlerën për trajtim 18,900€ derisa pagesa ishte bërë në vlerë 22,679€ me vendim të Ministrit.
- Nga programi për trajtimin e fëmijëve me leukemi bazuar ne mostrat tona janë paguar gjashtë raste që i takonin trajtimeve tjera. Vlera totale e tyre ishte16,090€. Shuma prej 980€ ishte paguar për subvencionimin e një pacienti për rrezatim edhe pse të njëjtit dy ditë më herët i ishte paguar një shumë e njëjtë për qëllimin e njëjtë nga programi TMJIPSH.
- Subvencioni prej 16,262€ për Shoqatën Diakonie Kosova ishte bërë nga dy kategori të shpenzimeve: nga subvencionet 8,131€ dhe nga Mallrat dhe Shërbimet 8,131€.

Rreziku Mungesa e një strategjie të qëndrueshme dhe të qartë për arsyetimin e plotë të shpenzimeve për TMJIPSH shkakton vështirësi në menaxhimin e kësaj kategorie të shpenzimeve dhe mund të krijoj mundësinë që të ndodhin pagesa të parregullta apo pagesa për shërbimet që nuk janë pranuar.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë që një marrëveshje formale e nënshkruar nga MSH-ja dhe përfituesi i paraprinë dhënies së subvencioneve për trajtime mjekësore duke qartësuar obligimet e të dyja palëve. Njëherit duhet të bëhen barazimet me të gjitha spitalet ku janë trajtuar pacientë të subvencionuar, për të përcaktuar nëse ekzistojnë parapagime, dhe nëse po mjetet e tilla të ri-destinohen.

Çështja 16 - Mjetet e lira ne Institucionet Private - Prioritet i lartë

E gjetura Një komision i formuar nga Ministria është angazhuar lidhur me barazimet financiare me disa institucione shëndetësore private. Nga puna e këtij komisioni ka rezultuar se në tetë institucione shëndetësore kishte mjete te lira prej 133,744€ të cilat ishin paguar për shërimin e pacientëve, por shërbimet nuk janë marrë. Në disa raste pacienti nuk ka shkuar për shërim, por ka raste kur për të njëjtin pacient janë paguar dy herë. Vetëm gjatë vitit 2014 MSH kishte subvencionuar shërimin e pacienteve në më shumë se 100 institucione shëndetësore. Vlera e mjeteve të paguara nëpër këto institucione është shumë më e madhe.

Rreziku Mungesa e raportimeve për kostot e trajtimit të pacientëve, rrit mundësinë e keqpërdorimit të këtyre mjeteve. Kjo shkakton më shumë shpenzime për Ministrinë dhe më pak trajtime të pacientëve.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të iniciojë krijimin e një rregullore/udhëzimi duke përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë dhe marrëdheniet në mes institucioneve shëndetësore publike dhe private duke specifikuar në mënyrë të qartë kërkesat për raportim financiar dhe në lidhje me shërbimet e ofruara.

Çështja 17 - Subvencionimi i pacientëve për shkak të mos-funksionalizimit të pajisjeve – Prioritet i lartë

E gjetura Ministria kishte subvencionuar, trajtime të cilat kanë mundur të ofrohen nga QKUK po të funksionalizoheshin pajisjet e blera: psh rasti i Brahoterapisë ku pajisja ishte blerë 652,000€, por nuk ishte në funksion, gjithashtu subvencionimet për rrezatime magnetike arrijnë vlerën prej 67,626€ edhe pse QKUK posedon rezonancën e cila poashtu nuk ishte në funksion.

Rreziku Mos funksionalizimi i pajisjeve të blera ka shkaktuar kosto shtesë për Ministrinë, pasi që është dashur të subvencionohen trajtimet e pacientëve për brahoterapi dhe rezonanca magnetike të cilat me një menaxhim më të mirë kanë mundur të jenë në funksion.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të sigurojë që institucionet përgjegjëse përkatëse të zbatojnë një vlerësim të plotë të statusit të pajisjeve. Kjo duhet të pasohet nga një strategji afatgjatë investimi për pajisjet dhe mirëmbajtjen si dhe riparimin e atyre ekzistuese.

Çështja 18 - Subvencionimi i pacientëve me barna të Listës Esenciale – prioritet i lartë

E gjetura Shuma prej 560,806€ nga subvencionet u është dhënë pacientëve të sëmurë kryesisht me kancer, për blerjen e barnave. Shumica e atyre barnave janë pjesë e listës esenciale dhe do të duhej të bliheshin përmes prokurimit nga mallrat dhe shërbimet.

Në një rast tjetër nga programi i trajtimit të fëmijëve me leukemi janë paguar barna të listës esenciale (shembull për ilaqin Docetaxel ishin paguar 874€).

Rreziku Menaxhimi i dobët i Listës Esenciale ka shfaqur nevojën e subvencionimit të pacientëve me barna të cilat përndryshe është dashur të sigurohen nga vetë Ministria.

Rekomandimi 18 Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së duhet të shtojë kontrollet në menaxhimin e kontratave për furnizim me barnat e listës esenciale në mënyrë që të ketë furnizim të rregullt me barna. Për këtë duhet të bashkëpunohet ngushtë edhe me Agjencionin për Financimin Shëndetësor si kontraktues i këtyre barnave.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, dhe me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Në pasqyrat financiare MSH ka paraqitur pasuri kapitale me vlerë neto prej 223,441,130€ që paraqet rritje prej afër 3% krahasuar me vitin paraprak. Nisur nga çështjet e diskutuara me parë kjo vlerë rezulton të jetë e mbivlerësuar.

Rekomandimi

Çështja 19 – Regjistra jo të plotë të pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura

MSH dhe programet vartëse nuk kanë ndonjë politikë të brendshme në lidhje me menaxhimin e pasurisë. Informatat në lidhje me pasuritë fikse në SIMFK dhe raportet e inventarizimit nuk ishin të besueshme ngase dallonin nga gjendja faktike e pasurive. Në regjistrin e pasurive me vlera mbi 1,000€ ka raste kur zhvlerësimi është llogaritur për pasurinë "tokë" derisa kategoria e tillë nuk zhvlerësohet. Në po ketë regjistër ka raste kur për pasuritë kapitale të blera, në vitin e parë disave u është llogaritur zhvlerësimi dhe disa të tjerave jo.

Në SP Prizren një tokë ishte regjistruar dy herë duke mbivlerësuar vlerën e pasurisë për 314,850€. Kishte edhe regjistrime bllok, ku pagesa për 39 shtretër është regjistruar si produkt i vetëm, derisa inventari i tjetërsuar në vlerë 288,198€, ka mbetur në regjistrat e pasurive dhe është shpalosur në PVF.

Edhe në SP Pejë vlera e pasurisë prej 28,801€, e nxjerrë jashtë funksioni nuk është fshirë nga regjistrat e pasurisë.

Rreziku

Mungesa e regjistrit të saktë dhe të plotë mbi të pasurisë, pengon menaxhimin efektiv të pasurive dhe vështirëson aplikimin e kontrolleve adekuate, vendim-marrjen në lidhje me investimet në pasuri dhe shkakton vështirësi tek parashikimet buxhetore. Keq prezantimi i pasurive në PVF mund të ndikoj në modifikimin e opinionit përfshirë theksimin e çështjes.

Rekomandimi 19

Ministri duhet të iniciojë një rishikim të rregullave dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë në sektorin e shëndetësisë. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen në vazhdimësi dhe vlera e saktë e pasurive duhet të shpaloset në PVF.

Çështja 20 - Mos dorëzimi i pajisjeve zyrtare me rastin e shkëputjes se marrëdhënies se punës – prioritet i mesëm

E gjetura Me rastin e ndërrimit të kabinetit të Ministrit, anëtarër e kabinetit të kaluar (me përjashtim të Ministrit dhe një këshilltari) nuk i kanë dorëzuar pasuritë e blera nga MSH (llaptopa, telefona zyrtar, aparate digjitale, e të ngjajshme). Edhe zyrtar të tjerë të larguar apo suspenduar nga puna kishin vepruar njëjtë. Ne testuam 10 raste ku vlera blerëse e pajisjeve të pakthyera arrin mbi 10,000€.

Rreziku Moskthimi i pasurisë së Ministrisë paraqet shkelje të rregullave ligjore, llogaridhënie dhe përgjegjësi të dobët si dhe ndikon në dëmtimin e reputacionit të Ministrisë. Përveq kësaj ajo shkakton edhe kosto shtesë për zëvëndësimin e pasurive të pakthyera.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë që janë shfrytëzuar të gjitha mekanizmat ligjore për kthimin e pasurive nga ana e anëtarëve të kabinetit të kaluar dhe nga stafi tjetër i larguar nga puna.

4.5.2 Menaxhimi i Barnave

Shpenzimet për blerjen e barnave gjatë vitit 2014 arrijnë vlerën 24,280,540€ apo rreth 22% të shpenzimeve totale, dhe paraqesin një fushë mjaft të ndjeshme për Ministrinë. Gjatë vitit 2014 kanë ndodhur një sërë reformash në fushën e menaxhimit të barnave dhe materialit nga lista esenciale. Pas ndryshimit të përgjegjësive, Agjencioni për Financim i Shëndetësisë (AFSH) është përgjegjëse për kontraktimin e barnave nga lista esenciale, derisa OE liferimin e barnave e bëjnë drejtpërdrejt tek institucionet shëndetësore të nivelit sekondar dhe terciar në bazë të kërkesave të këtyre të fundit dhe pas aprovimit nga AFSH.

Shënimet në lidhje me furnizimet nga lista esenciale evidentohen në Sistemin për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik (SMSF). Në aspektin e auditimit plotësia dhe shpalosja janë dy pohime të rëndësishme, ndërsa ne nuk kemi arritur të marrim siguri të mjaftueshme sa i përket kësaj fushe.

Rekomandimi

Çështja 21 - Menaxhim i dobët i stokut farmaceutik – Prioritet i lartë

E gjetura

Ministria nuk ka arritur të vendosur kontrolle adekuate sa i përket menaxhimit të Stokut Farmaceutik. Ne nuk kemi arritur të marrim siguri lidhur me informacionet e nxjerrura nga SMSF për arsye se gjendja reale dallon shumë nga të dhenat e futura në sistem. Krejt kjo për shkak se institucionet shëndetësore nuk i kanë evidentuar të dhënat si duhet.

Sa për ilustrim, stoku farmaceutik sipas PVF-ve 2013 ishte 17,398,790€ ndërsa si saldo filllestare në SMSF ishte paraqitur vlera 14,812,489€. Diferenca është 2,586,301€. Kjo shkakton konfuzitet në llogaritjen e stokut përfundimtar për vitin 2014 pasi të dhënat fillestare nuk janë të sakta. Poashtu saldo përfundimtare e Stokut Farmaceutik në PVF 2014 është 5,503,903€ derisa në SMSF figurojnë stoqe në vlerë 13,593,415€.

Stoku i shpalosur në PVF nga programi farmaceutik (barnat që menaxhohen nga departamenti farmaceutik në MSH e që janë të dedikuara për nivelin primar shëndetësor) ishte rreth 1.900,000€ (nga to **360,634€**, janë barna me afat të skaduar).

Barnatorja Qendrore në QKUK, nuk e ka shfrytëzuar SMSF për menaxhimin e stokut farmaceutik, por për një kohë ka shfrytëzuar një Softuer intern i cili me rastin e auditimit final, kemi vërejtur se nuk ishte në shfrytëzim dhe nuk ofronte mundësi për nxjerrjen e kurrfarë informatave. Për më tepër menaxhmenti i ri i Barnatores Qendrore të QKUK-së ka shprehur shqetësimet në lidhje me pranimin e detyrës pa asnjë të dhënë, dokument ose raport qoftë në formë fizike apo elektronike.

Këto diferenca kaq të mëdha në mes të informatave të shpalosura në PVF me të dhënat kontabël të MSH-së janë si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate nga ana e Menaxhmentit të MSH-së dhe SHSKUK-së.

Rreziku

Regjistrimet e pa sakta dhe jo të plota sjellin veshtirësi në menaxhimin e stokut farmaceutik duke shkaktuar shpeshherë mungesa të barnave nga lista esenciale dhe sasi të tepërta për artikuj të tjerë. Mos përdorimi i SMSF për evidentimit e të dhënave lidhur me furnizimet dhe distribuimin e barnave vetëm e ka rënduar gjendjen e menaxhimit të barnave. Kjo poashtu ka shkaktuar edhe paraqitjen jo të drejtë të stokut në PVF e cila do të ndikoj në modifikimin e opinionit të auditimit apo theksimin e çështjes.

Rekomandimi 21 Ministri duhet urgjentisht të iniciojë aplikimin e plotë të SMSF-së përgjatë procesit të furnizimit dhe distribuimit të barnave dhe materialit nga lista esenciale. Kualiteti i informatave në sistem duhet të rishikohet. Kjo do të mundësonte menaxhim më të lehtë dhe pasqyrë më të saktë në lidhje me gjendjën e stokut farmaceutik. Vlerat e sakta të stokut farmaceutik duhet të shpalosen në PVF për të shmangur ndonjë modifikim të opinionit apo theksim të çështjes në PVF 2015.

4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Sa i përket llogarive te arkëtueshme ne testuam faturat e lëshuara dhe të pa arkëtuara nga Inspektorati Shëndetësor (ISH), Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) si dhe Inspektorati Farmaceutik.

Çështja 22 – Mos prezentimi i Llogarive te Arkëtueshme në PVF – Prioriteti i mesëm

E gjetura Inspektorati Shëndetësor kishte shqiptuar gjoba në vlerë 150,200 euro prej të cilave janë inkasuar vetëm 37,100. Pjesa tjetër e pa paguar prej 113,100€ nuk ishte shpalosur në PVF.

Në AKPPM, në mungesë të informacioneve nga departamentet që krijojnë të hyra, nuk ishim në gjendje të arrijmë të konstatojmë sa të arkëtueshme ka secili departament. Të hyrat për Autorizim Marketing, për licencat për produkte dhe për autorizimet për import të pajisjeve, regjistrohen në një kod të përbashkët, dhe kjo shkakton vështirësi sa i përket identifikimit të secilit lloj te të hyrave.

Inspektorati Farmaceutik kishte shqiptuar gjoba në vlerë 224,200€, ndërsa vetëm 19,100€ kanë arritur të mblidhen. Diferenca nuk ishte paraqitur në PVF si të arkëtueshme. Për inkasimin e këtyre mjeteve AKPPM ka angazhuar një përmbarues privat.

Rreziku Mungesa e një qasje për mbledhjen e të arkëtueshmeve mund të rezultojë në fonde të pamjaftueshme për realizimin e shpenzimeve të planifikuara të realizohen përmes të hyrave vetjake. Mos shpalosja e të arkëtueshmeve zvogëlon cilësinë e PVF dhe jep pamje jo të saktë të informacioneve.

Rekomandimi 22 Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës sa i përket qasjes ndaj llogarive te arkëtueshme duke i identifikuar pengesat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Duhet të mbahen evidenca të sakta në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe informatat nga këto evidenca të shpalosen në PVF.

4.5.4 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014, të paraqitura në PVF ishte €3,029,430. Në krahasim me vitin paraprak kishte rritje për 6%. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015, qka do të thotë se e ngarkojnë buxhetin e vitit aktual.

Çështja 23 – Shpalosje jo e plotë e obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Obligimet e papaguara kanë trend të rritjes për qdo vit. Përveq kësaj jo të gjitha faturat e papaguara ishin shpalosur në PVF. 12 fatura të QKUK-së në vlerë 66,352€dhe 4 të tjera në SP Pejë me vlerë 4,912€, nuk ishin shpalosur në PVF.

Rreziku Prezantimi jo i plotë i obligimeve ndikon në cilësinë e informatave të shpalosura në PVF. Mungesa e informatave të sakta në lidhje me obligimet ndikon në planifikim të dobët të kërkesave buxhetore, krijon vështirësi financiare dhe ndikon në mos realizim të objektivave duke marrë parasysh se detyrimet duhet të financohen nga mjetet e parapara për projektet aktuale.

Rekomandimi 23 Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e kësaj çështje. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore, pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare dhe në PVF të shpalosen vlerat e sakta të detyrimeve.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së njësisë së auditimit të brendshëm (NjAB) dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti, si rezultat i punës së kryer nga NjAB dhe KA.

Auditimet e brendshme kanë përfshirë fusha me rëndësi për veprimtarinë dhe objektivat e organizatës. NjAB ka dokumentuar dhe analizuar problemet dhe ka propozuar zgjidhje për menaxhmentin. Pos planit të paraparë në Ministri, auditorët kanë participuar edhe ne auditimet pilot në MASHT dhe MKRS si pjesë e projektit për KBFP të financuar nga BE-ja. Ritheksojmë qe numri i limituar i stafit në raport me buxhetin/kompleksitetin e veprimtarisë së MSH-së përkatësisht SHSKUK-së, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive. Megjithatë në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor, ndryshimet janë të nevojshme edhe në këtë segment. Në lidhje me këtë Auditori i Përgjithshëm i ka dhënë ish Ministrit të Shëndetësisë sugjerimet e tij

Çështja 24 – Sistemi i Auditimit të brendshëm – Prioriteti i lartë

E gjetura Ministria nuk i ka përshtatur/ristrukturuar resurset e auditimit të brendshëm me strukturat e krijuara me procesin e reformave. Kjo ka bërë të pamundur që aktiviteti i auditimit të mbuloj të gjitha fushat dhe zhvillimet brenda sektorit shëndetësor.

Rreziku Mos përshtatja e burimeve të auditimit konform zhvillimeve të reja në sektorin shëndetësor zvoglon sigurinë e ofruar ndaj menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrolleve të brendshme. Kjo mund të ndikoj që zhvillime jo të përshtatshme të mbeten të pazbuluara.

Rekomandimi 24 Ministri duhet të iniciojë ristrukturimin e burimeve të auditimit të brendshëm me qëllim të përshtatjes me strukturat e reja të sektorit shëndetësor. Si pikënisje për këtë mund të merren propozimet që AP I kishte bërë ministrit të kaluar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë

një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	**Rekomandimet e dhena**	**Rekomandimet plotesisht te adresuara**	**Rekomandimet pjeserisht te adresuara**	**Rekomandimet e pa adresuara**
Pasqyrat Financiare	Rekomandimi 1: Ministri duhet ti analizojë arsyet për mungesën e regjistrit të plotë të pasurive dhe mbivlerësimin e stoqeve të barnave në PVF, dhe për mos zbatimin e këshillave të dhëna nga ZAP gjatë fazës së përkohëshme të auditimit. Duhet të zhvillohen proceset adekuate që sigurojnë evidenca të plota rreth pasurive dhe stoqeve si dhe paraqitje të saktë të tyre në PVF-të e vitit 2014			I pa adresuar .
Rekomandimet e vitit paraprak	Rekomandimi 2: Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme në mënyrë qe të përmirësohet funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe menaxhimi financiar			I pa adresuar - nuk ka ndodhur ndonjë rishikim i planit dhe implementimi i rekomandimeve nuk ishte në nivelin e duhur.

Realizimi i buxhetit	Rekomandimi 3: Ministri duhet të monitorojë performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Planifikimet buxhetore duhet ti marrin në konsideratë të gjitha burimet e fondeve duke përfshi edhe donacionet. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		Pjesërisht i adresuar. Përgatiten raporte të rregullta në lidhje me shpenzimet, mirëpo nuk ka dëshmi se menaxhmenti i lartë i ka shqyrtuar ato apo ka marrë masa konkrete në lidhje me adresimin e shmangieve nga plani.	
Te hyrat	Rekomandimi 4: Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm i cili ofron informata të sakta dhe në kohë; të siguroj respektimin e tarifave të aprovuara gjatë procesit të dhënies së licencave për punë; dhe të shtohen masat e veprimit në mbledhjen me kohë të të hyrave nga qiraja		Nuk është vendosur ndonjë sistem për evidentimin e të hyrave. Derisa tarifat për licencat janë respektuar.	

Shpenzimet-Prokurimi	Rekomandimi 5: Ministri duhet të rishikoj rastet e identifikuara për të përcaktuar pse mallrat nuk janë dorëzuar në përputhje me kushtet kontraktuale, pasojat e saj dhe masat e duhura dhe të përshtatshme duhet të ndërmerren për të siguruar që këto dobësi janë adresuar. Qasja e njejtë duhet të zbatohet edhe për të shmangur keq klasifikimin e shpenzimeve; Rekomandimi 6: Ministri duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe masat e duhura për evitimin e tyre në te ardhmen. Në veqanti duhet të sigurohet mbikqyrje adekuate e realizimit të kontratave. Me qëllim të evitimit të humbjeve nga mos kryerja e punëve apo nga cilësia e dobët e punimeve nga operatorët, duhet të sigurohet që siguria ekzekutimit të mbulojë të gjithë periudhën e përcaktuar me kontratë.		Pjesërisht i adresuar. Janë bërë sigurimet e ekzekutimit por nuk janë monitoruar si duhet implementimi i projekteve kapitale.	I pa adresuar. Edhe ketë vit janë identifikuar mospërputhje të furnizimeve me kontratat, si dhe keqklasifikim të shpenzimeve.

Shpenzimet jo përmes prokurimit	Rekomandimi 7: Ministri nëpermjet Agjencionit për Financimin Shëndetësor duhet të siguroj që pagesat për performancën e institucioneve dhe shërbyesve shëndetësor të bëhen konform udhëzimeve dhe marrëveshjeve të arritura. Monitorimi dhe vlerësimi i arritjes së përformancës duhet të bëhet në baza të rregullta mujore apo tremujore dhe vetëm pasi të dëshmohet se kriteret janë përmbushur të bëhen pagesat. Rekomandimi 8: Ministri duhet të siguroj që të gjitha institucionet shëndetësore do të aplikojnë procedurat adekuate me rastin e përzgjedhjes së shërbimeve të mbikqyrjes. Rekomandimi 9: Ministri duhet të siguroj që politikat dhe procedurat e aplikuara të mundësojnë rritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve me rastin e udhëtimeve zyrtare, duke dëshmuar dhe arsyetuar saktë shpenzimet e ndodhura dhe duke mbyllur me kohë avanset.	I adresuar I adresuar	I adresuar pjesërisht pasi akoma ka disa mangësi në arsyetimin e shpenzimeve me fatura.	

Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi 10: Ministri duhet të siguroj që në afatin sa më të shkurtër të bëhet plotësimi i pozitave udhëheqëse me staf të angazhuar me kontrata të rregullta. Kjo duhet të bëhet përmes procedurave të hapura publike.	I adresuar		
	Rekomandimi 11: Ministri duhet të bëjë një rishikim të kontratave të lartëpërmendura për të siguruar arsyeshmërinë e tyre dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore, si dhe të përcaktojë masat dhe veprimet e nevojshme që sigurojnë menaxhim efikas të detyrave dhe proceseve specifike në kuadër të Ministrisë. Angazhimi i stafit për detyra specifike me kontrata mbi vepër duhet të bëhet vetëm kur është e domosdoshme dhe në bazë të procedurave konkurruese dhe transparente			I pa adresuar janë evidentuar raste të angazhimit përmes kontratave për shërbimet e veqanta.
	Rekomandimi 12: Ministri duhet të rishikoj çështjen e funksionimit dhe pagesave të bordeve dhe komisioneve, në mënyrë që të përcaktohen masat e nevojshme për shmangien e pagesave të paarsyeshme. Të gjitha masat e propozuara duhet të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme dhe me synimet afatgjata të Ministrisë.			I pa adresuar – gjendja e njëjtë është përseritur.
	Rekomandimi 13: Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancimet e stafit dhe ngritja e pagave të jetë në pajtim me Ligjet e aplikueshme dhe politikat e Ministrisë.	I adresuar		

Subvencionet dhe Transferet	Rekomandimi 14: Ministri duhet të sigurojë që të shfrytëzohen të gjitha kapacitetet aktuale dhe të zhvillohen kapacitete të reja në kuadër të Institucioneve shëndetësore publike për trajtimin e sëmundjeve që aktualisht trajtohën jashtë këtyre institucioneve. Kjo do të ndikoj në zvogëlim të kostove të këtyre shërbimeve dhe në ngritjen e reputacionit të sistemit publik shëndetësor. Rekomandimi 15: Ministri duhet të konsideroj mundësinë e adaptimit të një udhëzuesi të brendshëm/qarkore në lidhje me këto trajtime, duke specifikuar qartë kushtet dhe kriteret mbi barazimet e rregullta financiare pas trajtimit të pacientëve.			I pa adresuar I pa adresuar – nuk ishte bërë ndonjë udhëzim në lidhje me këto trajtime.
Pasuritë dhe Detyrimet	Rekomandimi 16: Ministri duhet të siguroj ndërmarrjen e masave adekuate për harmonizimin e informatave rreth pasurive. Të gjitha pasuritë dhe stoqet duhet të evidentohen saktë dhe vlera e tyre të shpaloset në PVF. Rekomandimi 17: Ministri duhet të rishikoj vendimin për shfrytëzimin e automjeteve, për të siguruar arsyeshmërinë e tij dhe të vendosen kontrolle shtesë për shfrytëzimin e automjeteve duke siguruar që ato janë përdorur në pajtim të plotë me UA 03/2008. Të sigurohet llogaridhënie adekuate nga secili përdorues i automjeteve për të evituar përdorimin jo të rregullt të tyre.			I pa adresuar

Menaxhimi i barnave	Rekomandimi 18: Ministri duhet të siguroj një menaxhim më efikas të stokut farmaceutik. Çdo hyrje dhe dalje e stokut duhet të evidentohet në SMSF. Për diferencat e shfaqura të formohet një komision i veçantë dhe të jepen sqarimet e duhura. Rekomandimi 19: Ministri duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara si çështje urgjente, për të identifikuar masat e nevojshme për sigurimin e regjistrimeve të sakta në sistemin SMSF për përmirësimin e sistemit aktual elektronik. Nevoja për një monitorim të funksionimit të SMSF-së, në baza të rregullta mujore të duhet merret në konsideratë. Rekomandimi 20: Ministri duhet të rishikojë funksionimin e procesit të furnizimit me barna, në mënyrë që gjatë implementimit të reformave të evitohen dobësitë e identifikuara. Duhet të krijohen mekanizma adekuat që sigurojnë monitorim të procesit që nga planifikimi e deri tek shpërndarja e tyre tek pacientët. Praktika e pranimit të barnave me afat të shkurtë të qëndrueshmërisë duhet të ndërprehet me qëllim të zvogëlimit të kostove. Rekomandimi 21: Ministri duhet të siguroj aplikimin e politikave dhe procedurave që sigurojnë monitorim efikas të procesit të furnizimit me barna. Përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në ketë proces duhet të jenë të qarta për të mundësuar që procesi të jetë transparent dhe llogaridhënia të jetë në nivelin e duhur.		Pjesërisht i adresuar. Mënyra e furnizimit me barna dhe përgjegjësitë në ketë proces kanë ndryshuar. Mbetet të shihet në të ardhmen se si do të funksionojë në të ardhmen. Pjesërisht i adresuar – shih komentin më lartë	I pa adresuar I pa adresuar

Detyrimet e papaguara	Rekomandimi 22: Ministri duhet të rishikoj gjendjen e detyrimeve të papaguara dhe atyre kontigjente, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuara. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore dhe pagesat të bëhen në bazë të vjetërsisë së tyre. Të gjitha obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente duhet të shpalosen në PVF.		Pjesërisht e adresuar	
Sistemi i auditimit ë brendshëm	Rekomandimi 23: Ministri duhet të siguroj që Komiteti i Audimit në Ministri është plotësisht operacional, në afat të shkurtër duke i ofruar asistencë në adresimin e rekomandimeve nga auditorët. Në afat të mesëm Ministri duhet të marrë parasysh organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në pajtim me një nga opcionet e propozuara nga Auditori i Përgjishëm në Memorandumin "Funksionimi i auditimit të brendshëm në Sektorin e Shëndetsisë dhe nevojat për përshtatjën e reformave".		Pjesërisht i adresuar	